



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

DOKUMENTI KONSULTATIV

**Për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 16/2018, “Për Diasporën”,
i ndryshuar”**

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, në kuadër të procesit të konsultimit të projektligjit mirëpret sugjerime konkrete nga:

Këshilli Kordinues i Diasporës;
Këshilli Kordinues i Arsimitarëve në Diasporë;
Organizatat e diasporës;
Individë me kontribut në diasporë.

Kohëzgjatja e konsultimeve:

Kohëzgjatja e konsultimit nga palët e interesuara është 20 ditë pune nga dita e publikimit në RENJKP, duke filluar nga data **4 mars** deri më **29 mars 2024**.

Si të përgjigjeni:

Kontributi juaj me sugjerime konkrete, në kuadër të përmirësimit të përmbajtjes së projektligjit, të dërgohet nëpërmjet:

1. Regjistrin Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimin Publik duke klikuar në lidhjen e akteve të publikuara për konsultim nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, si vijon: <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Institucioni/113>
2. Në adresën e postës elektronike zyrtare të Koordinatorit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik të MEPJ: konsultimipublik@mfa.gov.al

Kontakti:

Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik: konsultimipublik@mfa.gov.al

Datat dhe vendet e takimeve publike:

Vendi: Në portalin e Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike.

Datat: 20 ditë nga shpallja e projektaktit për konsultim në RENJKP (4-29 mars 2024).

Sfondi i propozimit legjislativ

Projektligji për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.16/2018 “Për diasporën”, i ndryshuar, vjen si rezultat i miratimit të vendimit nr.81, datë 09.02.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme”, sipas të cilit MEPJ caktohet si institucion përgjegjës për Diasporën, përgjegjësi kjo që më parë i përkiste Ministrit të Shtetit për Diasporën.

Në këto kushte, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme i lind detyrimi për të bërë një analizë të kuadrit ligjor në fuqi, për çështjet e diasporës, duke mbajtur në konsideratë politikën shtetërore dhe objektivat e MEPJ-së për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të shtetasve shqiptarë, që jetojnë jashtë kufijve të RSH-së.

Në përfundim të kësaj analize, u vlerësua rishikimi i ligjit nr.16/2018 “Për diasporën” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Gjithashtu, ndryshimet synojnë të shmangin mospërputhjen e kuadrit rregullator për diasporën, si pasojë e ndryshimeve të menjëhershme që sjell shfuqizimi i ligjit nr.115/2017 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, i cili vendosi që niveli i autoritetit shtetëror përgjegjës për marrëdhëniet me diasporën të rritet nga niveli i një Agjencie Kombëtare, në nivel Ministrie për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Për rrjedhojë, këto ndryshime janë vlerësuar të domosdoshme të reflektohen edhe në ligjin nr.16/2018 “Për diasporën”, i ndryshuar, të cilat konsistojnë në formë dhe përmbajtje, kryesisht sa i takon organizimit të veprimtarisë së strukturave, funksionit dhe përgjegjësisë që do të kenë, në mënyrë që të shmangen mospërputhjet e kuadrit rregullator.

Duke marrë në konsideratë që diaspora është e gjerë, e shtrirë në të gjitha kontinentet si dhe e lëvizshme gjeografikisht, pasi numri i shqiptarëve jashtë ndryshon gjatë kohës nga një shtet në tjetrin, kemi shtuar numrin e Këshillit Koordinues të Diasporës nga 15, në jo më pak se 21 dhe kemi hequr specifikimin e shteteve nga zgjidhen anëtarët e KKD-së, pasi ky specifikim mund të linte jashtë shumë vende apo dhe kontinente ku shqiptarët janë të pa përfaqësuar, duke e bërë më gjithëpërfshirës ligjin.

Propozimet

Në projektligjin që paraqitet për shqyrtim janë bërë riformulime paragrafesh në ligjin nr.16/2018, me qëllim përmirësimin e tekstit, si edhe adresimin e sugjerimeve konkrete nga diaspora gjatë Samitit të III-të Diasporës.

Në vija të përgjithshme, Agjencia Kombëtare e Diasporës është kaluar si institucion në varësi të Ministrit përgjegjës për diasporën.

Janë shfuqizuar neni 4, pika 1, (Komiteti Shtetëror për Diasporën) dhe neni 22 (Fondi i Zhvillimit për Diasporën) i ligjit nr.16/2018, pasi këto organe e kanë humbur funksionin e

tyre.

Në nenin 10 të ligjit nr.16/2018, është shtuar gjuha arbëreshe, si një nga gjuhët që duhet përkrahur për ruajtjen dhe lëvrimin e saj.

Në nenin 18 të ligjit nr.16/2018, janë riformuluar në funksion të qartësisë dhe përmirësimit, funksionet dhe përgjegjësitë e Këshillit Kombëtar të Diasporës, si edhe është rritur numri i pjesëmarrësve në Këshill në nenin 19 të ligjit.

Në nenin 20 të ligjit nr.16/2018, janë hequr vendet të përcaktuara specifikisht nga përbërja e Këshillit duke lënë të hapur mundësinë e përfshirjes së vendeve të tjera ku ka diasporë, në numër më pak të konsiderueshëm.

Pyetjet

Po listojmë disa nga pyetjet për të cilat kërkojmë reagime, por jeni të lutur të dërgoni sugjerime konkrete për projektligjin në përgjithësi.

A jeni dakord me propozimin për rritjen e numrit e anëtarëve të Këshillit Koordinues të Diasporës?

A jeni dakord me moskufizimin gjeografik të anëtarëve të Këshillit Koordinues të Diasporës?

A jeni dakord që duhet të ndërmerren veprime të mëtejshme për gjuhën arbëreshe, si një nga gjuhët që duhet përkrahur për ruajtjen dhe lëvrimin e saj?